REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME
Zyra e Kryetarit

Data/Datum/Date:	02.11.2022
Nr./Br./No	02/1-150
Për/Za/To:	Kanidatët/Publikun
Nga/Od/From:	Ardita Ndrecaj, u.d Menaxhere e Personelit
Lënda/Predmet/Subject :	Njoftim per shpalljen e Konkursit për Pranim, pozita: Inspektor i ndërtimit, Drejtoria për shërbime Publike

Duke u bazuar në nenin 68 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Njësia e Burimeve Njerëzore ju njofton se është hapur procedura e Konkursit për pranim të jashtëm për pozitën Inspektor i ndërtimit, koeficienti 7.5 në Drejtorinë për Shërbime publike, Sektori për Inspektorat në Komunën e Shtimes.

Të interesuarit mund të aplikojnë nga data 23.11.2022 deri me datën 30.11.2022.

Për më shumë informata referojuni Konkursit me numër të Referencës RN00010336, datë 02.11.2022, vazhdim i këtij njoftimi i shpallur në web faqen e Komunës së Shtimes dhe gjithashtu i shpallur në sistemin SIMBNJ.

Për qdo paqartësi mund te drejtoheni në Zyren e Personelit në Komunën e Shtimes.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E SHTIMES
OPŠTINA STIMLJE / MUNICIPALITY OF SHTIME

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 34 (2 dhe 3) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Nenet: 7 dhe 9, Komuna Shtime shpall:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Emri i grupit	Specialistë të inxhinierisë të Ndërtimit
Institucioni	Komuna Shtime
Nr. i Referencës	RN00010336
Kodi	RPC0004028
Data e njoftimit	02.11.2022
Afati për aplikim	23.11.2022 - 30.11.2022

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

i. Zhvillon procedura sipas kërkesave dhe fletparaqitjeve të qytetarëve, ndërmarrjeve dhe instituvcioneve tjera.
ii. Propozon masa preventive me qëllim të pengimit të shkejleve të dispozitave ligjore që rregullojnë lëminë e ndërtimtarisë
iii. Urdhëron ndërmarrjen e masave dhe veprimeve për eliminimin e parregullsive të konstatuara në afat të paraparë me ligj ose në mungesë të rregullores e përcakton afatin e vet.
iv. Urdhëron që të paraqitet dokumentacioni dhe shënimet në afat të caktuar për lëminë e ndërtimit
v. Urdhëron rrënimin dhe largimin e objekteve të filluara ose të ngritura pa leje dhe kthim në gjendjen e mëparshme
vi. Ndalon ndërtimin e objekteve pa leje, shqipton dënimin mandator
vii. E drejta që në çdo kohë të inspektojë objektet që janë në ndërtim e sipër, të shikohet se a është duke u punuar sipas planit për të cilin më parë është dhënë leja ndërtimore.
viii. Merr masa për evitimin e rrezikut për jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe mbron interesat komunale
ix. Punët e inspektorit janë të natyrës urgjente si dhe në lëminë përkatëse punon edhe jashtë orarit tetë orësh.

2. Kërkesat e përgjithshme për pranim

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

-Diplomë/a të studimeve, Fakulteti i Ndërtimtarisë, Fakultetin Juridik. universitare me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to (Në rastin kur kreditë janë mbledhur si pasojë e diplomës Bachelor dhe Master. Fusha e Diplomës Master të jetë e njëjtë apo vazhdim (specializim) i Diplomës Bachelor.

-Kualifikime të posaçme formale

-Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy vite përvojë pune profesionale në fushë për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

-Njohuri të thellë dhe të speciaizuara në fushën profesionale specifike

-Nivel të larrtë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë

-Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike.

- Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës

-Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskretcion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave

-Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këhsillave profesionale.

-Aftësi komunikimi dhe ndikim personal përfshirë aftësitë për të përfaqësuar

5. Pozitat aktualisht të lira

Kodi	Nr. i Referencës	Titulli i pozitës	Klasa e pozitës	Koeficienti	Institucioni	Organizata / Vendi i punës
RPC0003783	RN00010081	Inspektor i Ndërtimit	Profesional 1	7.5	Komuna Shtime	Drejtoria e Sherbimeve Publike / Komuna Shtime

6. Mënyra e aplikimit

Përmes portalit për rekrutim elektronik (https://konkursi.rks-gov.net)

7. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim
- Vlerësimi i biografisë
- Intervistë

9. Fusha e njohurive, cilësive dhe aftësive që do të vlerësohen

-Njohuri profesionale specifike në fushën përkatëse të punës, të fituara përmes arsimimit dhe trajnimeve bazike

-Aftësi për të kuptuar dhe abatuar praktikat operative për të përmirsuar efikasitetin

-Njohuri lidhur me procedurat standarde administrative/teknike në fushën e caktuar

-Aftësia e vendimarrjes dhe metodologjia e punës

-Komunikimi, planifikimi i punës, koordinimi dhe bashkëpunimi

10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutim elektronik (https://konkursi.rks-gov.net)

11. Shpallja e rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutim elektronik (https://konkursi.rks-gov.net). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.
Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.
Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen